



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 18936 Prot.

Lezhë, më 27 . 12 . 2023

VENDIM

Nr. 77, Datë 27. 12. 2023

Për

Miratimin e Kalendarit të Përgatitjes së PBA-së 2025-2027 dhe të Buxhetit të vitit 2025

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; dhe të Udhëzimit të MFE nr. 23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të qeverisjes vendore”, i ndryshuar; me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

Vendosi :

I.Miratimin e Kalendarit të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 dhe të Buxhetit të vitit 2025, si më poshtë;

Nr	Përshkrimi i Veprimtarisë	Afati	I ngarkuar për zbatim
1	Përgatitja dhe dërgimi në këshill për miratim i Kalendarit të Përgatitjes së PBA-së 2025-2027 dhe Buxhetit të vitit 2025.	Deri me datë 05.12.2023	Kryetari i Bashkisë Dr.Financë & Buxh.
2	Miratimi i Kalendarit të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 dhe Buxhetit të vitit 2025.	Deri me datë 25.12.2023	Këshilli i Bashkisë
3	Përgatitja dhe paraqitja në këshill të Raportit të Vlerësimit dhe të Parashikimit Afatmesëm të të ardhurave për dy vitet e para të vitit buxhetor, vitin buxhetor dhe tre vitet e ardhshme. Në raport duhet të përfshihen; -metodologjia e përdorur për parashikimet afatmesme të të ardhurave; -analiza e efekteve të politikave të reja fiskale ose ndryshimet e tyre. -analiza e risqeve dhe masave për përballimin e tyre.	Deri me datë 31.01.2024	Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Drejtoritë e tjera
4	Përgatitja e paraqitja në këshill për miratim, i prioriteteve dhe projekteve për investime e kostos së tyre. Qëllimet, objektivat dhe politikat sipas programeve, duke u adresuar edhe në respektimin e të ligjit “Për barazinë gjinore”.	Deri me datë 20.02.2024	Dr. Integritet Europian, Dr. Planifikimit Urban, në bashkëpunim me drejtoritë e tjera
5	Miratimi i Raportit të Vlerësimit dhe të Parashikimeve afatmesme të të ardhurave, prioriteteve të investimeve për të tre vitet e ardhshme 2025-2027.	Deri me datë 20.02.2024	Këshilli i Bashkisë
6	Përgatitja dhe paraqitja në këshillin e bashkisë të tavanëve përgatitore të shpenzimeve buxhetore të PBA-së 2025-2027 në nivel programi të miratuar nga GMS-ja.	Deri me datë 01.03.2024	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
7	Miratimi i tavanëve përgatitore të shpenzimeve të PBA-së 2025-2027 në nivel programi	Deri me datë 15.03.2024	Këshilli i Bashkisë

8	Hartimi i udhëzimit përkatës për përgatitjen e PBA-së 2025-2027, i cili duhet të përmbajë; -përcaktimin e programeve buxhetore dhe EMP përkatëse; -tavanet përgatitore të shpenzimeve në nivel programi për tre vitet, të miratuar nga këshilli i bashkisë; -afatet e përgatitjes së kërkesave të shpenzimeve (faza I ^{re})	Deri me datë 20.03.2024	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
9	Miratimi i udhëzimit përkatës për përgatitjen e PBA-së 2025-2027 dhe të Buxhetit të vitit 2025.	Deri me datë 20.03.2024	Kryetari i Bashkisë
10	Dërgimi i udhëzimit, manualit shpjegues, modelin e matricës, dhe kërkesave për plotësim nga EMP-ve (drejtoritë)	Deri me datë 22.03.2024	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
11	Plotësimi i matricave, fish/projekteve dhe paraqitja e kërkesave buxhetore sipas programeve nga EMP-it, dhe dorëzimi i tyre në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit me shkresë zyrtare, si dhe në mënyrë elektronike.	Deri me datë 05.05.2024	Drejtuesit e EMP (gjithë drejtoritë)
12	Zhvillimi i dëgjësive publike dhe konsultimeve me komunitetin dhe grupet e interesit, lidhur me nivelin e taksave, tarifave, dhe prioritetet e investimeve për tre vitet e ardhshme	Deri me datë 05-20.05.2024	Kryetari i Bashkisë G.M.S-ja
13	Përgatitja dhe paraqitja për vlerësim dhe miratim nga Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) i PBA-së dhe kërkesave buxhetore të paraqitura nga drejtuesit e programeve (EMP).	Deri me datë 25.05.2024	Dr. Financës dhe Buxhetit GMS-ja
14	Dërgimi me shkrim dhe rrugë elektronike të projektdokumentit të PBA 2025-2027 në Ministrinë e Financës & Ekonomisë	Deri me datë 01.06.2024	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
15	Paraqitja për miratim në këshillin e bashkisë të projektdokumentit të PBA-së 2025-2027, të miratuar nga GMS-ja.	Deri me datë 01.06.2024	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
16	Shqyrtimi dhe miratimi i projektdokumentit të PBA-së, për fazën e parë nga ana e këshillit të bashkisë	Deri me datë 30.06.2024	Këshilli i Bashkisë
17	Publikimi i dokumentit të parë të PBA-së 2025-2027, pasi të jetë miratuar nga këshilli bashkiak.	Deri me datë 05.07.2024	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
18	Përgatitja dhe paraqitja në këshillin e bashkisë për miratimin të tavanëve përfundimtare të shpenzimeve të PBA-së për tre vitet e ardhshme në nivel programi për fazën e dytë.	Deri me datë 15.07.2024	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
19	Shqyrtimi dhe miratimi i tavanëve përfundimtare të shpenzimeve të PBA-së në nivel programi.	Deri me datë 20.07.2024	Këshilli i Bashkisë
20	Hartimi i udhëzimit plotësues për përgatitjen e buxhetit, i cili përmban: -tavanet përfundimtare të shpenzimeve në nivel programi; -afatet e përgatitjes së kërkesave buxhetore; -udhëzimi i miratuar nga kryetari i bashkisë, ju dërgohet gjithë drejtuesve EMP-it (drejtorive).	Deri me datë 25.07.2024	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
21	Pas finalizimit të projektdokumentit të parë të rishikuar, e të publikuar, të organizohen dëgjesa publike me komunitetin dhe grupet e interesit. Në këto takime duhet të mbahen procesver-bale, të bëhen regjistrime filmike, të cilat do të bëhen pjesë e dokumentit të PBA-së.	Gjatë muajit Gusht 2024	Kryetari i Bashkisë G.M.S-ja Këshilli i Bashkisë
22	Pargatitja dhe paraqitja për miratim në këshill të dokumentit të rishikuar të PBA-së.	Deri me datë 01.09.2024	Dr. Financës dhe Buxhetit GMS-ja
23	Miratimi nga këshilli bashkiak i dokumentit të rishikuar të PBA-së 2025-2027.	Deri me datë 10.09.2024	Këshilli i Bashkisë
24	Dërgimi në Ministrinë e Financës & Ekonomisë të dokumentit të PBA-së së rishikuar, të miratuar nga këshilli, shoqëruar me një informacion mbi zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga MFE në fazën e parë.	Deri me datë 15.09.2024	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
25	Pas marrjes së mendimeve përfundimtare nga MFE, të bëhet përgatitja e projektit të PBA-së 2025-2027 dhe	Deri me datë 25.11.2024	Drejtoria e Financës Drejtuesit e EMP-it dhe GMS-ja

	projektbuxhetit për vitin 2025. Miratimi nga GMS-ja.		
26	Projektdokumenti i PBA-së 2025-2027 dhe projektbuxheti për vitin 2025 të paraqitet për miratim nga këshilli i bashkisë	Brenda datës 30.11.2024	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, GMS-ja
27	Shqyrtimi dhe miratimi i PBA-së 2025-2027 dhe projektbuxhetit të vitit 2025.	Deri me datë 25.12.2024	Këshilli i Bashkisë
28	Publikimi i dokumentit të plotë të PBA-së dhe buxhetit të vitit 2025 së bashku me dokumentacionin shoqërues të tij.	Deri me datë 31.12.2024	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit

II.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak.

III.Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ**



**KRYETARI
NDUE LULI**

**Në mungesë dhe me autorizim
ZV/KRYETARI
AGOSTIN MARKU**



Prot 18936/1

Dt 8.1.24



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË
SEKTORI JURIDIK

Nr. 1041/6 Prot.

Lezhë, më 03.01.2024

Lënda: Konfirmim vendimi

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

Për Dijeni : KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË

Bazuar në nenin 16 pika 2 gërma "b" të ligjit Nr.107/2016, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr.68, datë 27.04.2017 "Për financat e Vetëqeverisjes vendore", ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë të ndryshuar", si dhe Udhëzimin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave nr.23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të të përgaditjes së programit buxhetor afatmesëm të njësisve të qeverisjes vendore", konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr.77, datë 27.12.2023 të këshillit të bashkisë Lezhë "Për miratimin e kalendarit të përgaditjes së PBA-së 2025-2027 dhe të buxhetit të vitit 2025".

P R E F E K T I

Gjergj PRENDI


